



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM Nr.130, Datë 30.03.2020

### PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT TË CAKTIMIT TË PËRKOHSHËM DHE TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

#### VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Transferimin e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 06.03.2020 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas Ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
3. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja “b”, e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**